



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.1606/3 Prot

Tiranë, më 10.11.2023

VENDIM

Nr.52, datë 10.11.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, gazetare pranë Qendrës “Amfora.al”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1606 prot., datë 03.10.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës datë 07.09.2023, depozituar në adresën elektronike info@iktk.gov.al, ka kërkuar t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

1. Nje kopje të propozimeve/kërkesave të:
 1. Individëve/subjekteve të interesuara (private);
 2. Institucioneve të kulturës, si Drejtoritë e Rajonale të Trashëgimisë Kulturore;
 3. Ministria Kulturës/Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të paraqitura për heqjen e pjeshme ose të plotë nga lista të monumenteve të kulturës të objekteve të caktuara të të dyja kategorive (e parë dhe e dytë); Për secilin prej tyre bashkëlidhni:
 - a) Dokumentet/raportet teknike dhe raportet e mbledhjeve për rastet/monumentet që janë marë në shqyrtim (si në rastet kur janë hequr edhe në rastet kur nuk janë hequr nga lista por vetëm janë propozuar për tu hequr);
 - b) Në rastet kur është vendosur heqja nga lista e moumenteve të kulturës të objektit përkatës, na vendosni në dispozicion një kopje të relacionit teknik;

- c) Në rastet kur është vendosur heqja nga lista e monumenteve të kulturës të objektit përkatës, na vendosni në dispozicion një kopje të kartelës së monumentit (përfshirë skicat dhe çdo të dhënë tjetër teknike);
- d) Në rastet kur është vendosur heqja nga lista e monumenteve të kulturës të objektit përkatës, na vendosni në dispozicion një kopje të vendimit/eve përkatëse nga këshillat shkencorë dhe institucionet e kulturës;
2. A keni realizuar studime teknike apo fizibiliteti për objektet në mënyrë individuale apo në grup, për monumentet e hequra nga listat e trashëgimisë kulturore në qarqet dhe për periudhën e specifikuar? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje;
3. Bazuar në kompetencat dhe inspektimet e IKTK-së për gjendjen e monumenteve të kulturës në të gjithë vendin, a keni realizuar inspektime vlerësimi për gjendjen e monumenteve të kulturës përgjatë vitit 2023 apo në 5 vitet e fundit? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje.
4. Na vendosni në dispozicion një kopje të listave të monumenteve të kulturës për periudhën kohore nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër (të gjitha listat që kanë qenë në fuqi sipas periudhave kohore që kanë pasuar), ndarë sipas monumenteve të kulturës së kategorisë I, II dhe të Zonave të Mbrojtura;
5. A ka raste që IKTK ka dërguar për ndjekje penale apo në procese gjyqësore civile, persona/subjekte, të cilët kanë dëmtuar monumentet e kulturës nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të dokumenteve për secilin rast;
6. Na vendosni në dispozicion listën me monumentet e kulturës të të dyja kategorive që i janë shtuar listës së mbrojtjes nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkoder, Tiranë, Durrës, Korçe, Berat, Vlorë, Gjirokastër?;
7. Na vendosni në dispozicion listën me monumentet e kulturës të restauruara nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër?
8. Për periudhën nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër, sa monumente janë evidentuar: 1. Që nuk ekzistojnë më? 2. Janë plotësisht të shkatërruara? 3. Sa janë në gjendje të pranueshme, por që kanë nevojë për restaurim? 4. Sa janë në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme? 5. Sa objekte janë tjetërsuar? dhe 6. Sa objekte janë pa kartelë?

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesja i është drejtuar Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 1606/1 Prot., datë 06.10.2023, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore. Seanca u zhvillua me prezencën e ankueses dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesja rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë. Ndërkohë, përfaqësuesit e Autoritetit Publik vendosën në dispozicion të ankueses një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, si dhe depozituan pranë Komisionerit pretendimet e tyre me shkrim.

Pas seancës dëgjimore, ankuesja, me e-mail-in datë 27.10.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1606/2, datë 30.10.2023, ka vijuar ankimin duke kërkuar urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikën nr. 1, gërma a, b, c dhe pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kërkesës për informacion.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik në seancën dëgjimore dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik për ankesën e paraqitur, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj*”. Në kuptim të këtij parashikimi, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Lidhur me pretendimin e Autoritetit Publik se, *“Subjekti ankues është shprehur se ka vetëm qëllime gazetareske të cilat përfaqësojnë interesin publik, por nuk ka sjellë prova apo argumente ligjore, për të shprehur një interes publik më të lartë për dhënien e tij sipas pikës 1 të nenit 17 të LDI”*, Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 3 të LDI, *“Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacion publik, pa u detyruar të shpjegojë motive”*.

Konstatohet se, Autoriteti Publik nuk ka argumentuar lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar bazuar në kufizimet që parashikon neni 17 i LDI si dhe nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, proporcionale, në mënyrë të tillë që të bënte dhe vlerësimin e interesit publik më të lartë. Në çdo rast, duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me monumentet e kulturës, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me administrimin dhe mirëmbajtjen e tyre, në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë.

Referuar pretendimit të Autoritetit Publik se: *“Relacionet teknike, studimet dhe procesverbalet e mbledhjeve nuk mund të vihen në dispozicion pasi trajtohen sipas Ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Komisioneri vlerëson se ky i fundit nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në përputhje me dispozitat e ligjit të sipërcituar. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, “Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”. Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesat e ankueses për t’u informuar nuk cenojnë apo zhveshin autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.*

Nisur nga pretendimi i Autoritetit Publik se, *“Bazuar në nenin 7, “Kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë” të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, IKTK ka publikuar në faqen e internetit informacionin publik mbi veprimtarinë e institucionit, duke përfshirë edhe ato kategori të cilat, sipas gërmes “I” vlerësohen nga Autoriteti Publik si informacione të dobishme për t’u aksesuar nga publiku”, Komisioneri vlerëson se argumenti i dhënë nuk qëndron, pasi në kategorinë e sipërcituar bën pjesë informacioni që konsiderohet dhe bëhet publik pa kërkesë.*

Sqarojmë se LDI, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.* Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vihen në dispozicion nga Autoriteti Publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, ndërsa rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, që përfshin ato informacione për njohjen e të cilave është e nevojshme të paraqitet një kërkesë për informim pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit

11 e vijues të LDI, detyrim të cilin Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur për pikat e kërkesës për informacion, për të cilat ankuesja ka vijuar dhe ankimin e tyre me emailin datë 27.10.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1606/2, datë 30.10.2023.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar, në parim përbën informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përfundimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, kërkuari/ankuesja është gazetare, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së znj. _____, nr. 1606 prot., datë 03.10.2023, ndaj Autoritetit Publik, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 07.09.2023, konkretisht: (1. Një kopje të propozimeve/kërkesave të: 1. Individëve/subjekteve të interesuara (private); 2. Institucioneve të kulturës, si Drejtoritë e Rajonale të Trashëgimisë Kulturore; 3. Ministria Kulturës/Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, të paraqitura për heqjen e pjesshme ose të plotë nga lista të monumenteve të kulturës të objekteve të caktuara të të dyja kategorive (e parë dhe e dytë); -Për secilin prej tyre bashkëlidhni: a) Dokumentet/raportet teknike dhe raportet e mbledhjeve për rastet/monumentet që janë marë në shqyrtim (si në rastet kur janë hequr edhe në rastet kur nuk janë hequr nga lista por vetëm janë propozuar për tu hequr); b) Në rastet kur është vendosur heqja nga lista e monumenteve të kulturës të objektit përkatës, na vendosni në dispozicion një kopje të relacionit teknik; c) Në rastet kur është vendosur heqja nga lista e monumenteve të kulturës të objektit përkatës, na vendosni në dispozicion një kopje të kartelës së monumentit (përfshirë skicat dhe çdo të dhënë tjetër teknike); 2. A keni realizuar studime teknike apo fizibiliteti për objektet në mënyrë individuale apo në grup, për monumentet e hequra nga listat e trashëgimisë kulturore në qarqet dhe për periudhën e specifikuar? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të tyre; 3. Bazuar në kompetencat dhe inspektimet e IKTK-së për gjendjen e monumenteve të kulturës në të gjithë vendin, a keni realizuar inspektime vlerësimi për gjendjen e monumenteve të kulturës përgjatë vitit 2023 apo në 5 vitet e fundit? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje. 4. Na vendosni në dispozicion një kopje të listave të monumenteve të kulturës për periudhën kohore nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër (të gjitha listat që kanë qenë në fuqi sipas periudhave kohore që kanë pasuar), ndarë sipas monumenteve të kulturës së kategorisë I, II dhe të Zonave të mbrojtura; 5. A ka raste që IKTK ka dërguar për ndjekje penale apo në procese gjyqësore civile, persona/subjekte, të cilët kanë dëmtuar monumentet e kulturës nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të dokumenteve për secilin rast; 6. Na vendosni në dispozicion listën me monumentet e kulturës të të dyja kategorive që i janë shtuar listës së mbrojtjes nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër?; 7. Na vendosni në dispozicion listën me monumentet e kulturës të restauruara nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër? 8. Për periudhën nga viti 2000 - qershor 2023, për qarqet Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Berat, Vlorë, Gjirokastër, sa monumente janë evidentuar: 1. Që nuk ekzistojnë më? 2. Janë plotësisht të shkatërruara? 3. Sa janë në gjendje të pranueshme, por që kanë nevojë për restaurim? 4. Sa janë në gjendje të mirë dhe në nevojë për një mirëmbajtje të vazhdueshme? 5. Sa objekte janë tjetërsuar? dhe 6. Sa objekte janë pa kartelë?)”.

- duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, brenda datës 17.11.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” i ndryshuar.
 4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.11.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi